




UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN



SENATI

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel: +383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Datë: 24.10.2023

NJOFTIM
për angazhimin e personelit akademik për vitin akademik 2023/2024

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren në mbledhjen e mbajtur më datë: 24.10.2023, pas shqyrtimit të propozimeve të njëjësive akademike, miratoi pjesërisht propozimet dhe vendosi për pranimin kandidatëve për angazhim për vitin akademik 2023/2024, sipas konkursit me nr. 01-578/A, të datës 22.9.2023 të njëjësive akademike si më poshtë:

• **FAKULTETI I EDUKIMIT**

Miratohet pjesërisht propozimi i Këshillit të Fakultetit të Edukimit në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren për angazhimin e personelit akademik për vitin akademik 2023/2024.

Pika 15 e raportit me nr. 02-477, dt. 20.10.2023 kthehet për rishqyrtim në Këshillin e Fakultetit të Edukimit.

Ndryshohet pika 50 me lëndën: Histori Kombëtare – Parafillor (2 orë/L + 2 orë/U) dhe pika 70 me lëndën: Histori Kombëtare – Fillor (3 orë/L + 2 orë/U) në të cilat lëndë angazhohet z. Fari Avdija.

• **FAKULTETI JURIDIK**

Miratohet propozimi i Këshillit të Fakultetit Juridik në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren për angazhimin e personelit akademik për vitin akademik 2023/2024.

Dr. Fehim Mazreku angazhohet në lëndën: Mjeksi ligjore L+U, 2+1, meqenëse pika 3 e propozimit me nr. 02-514, dt. 23.10.2023 i është lënë në diskrecion të Senatit për vendosje.

• **FAKULTETI I EKONOMISË**

Miratohet pjesërisht propozimi i Këshillit të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren për angazhimin e personelit akademik për vitin akademik 2023/2024.

Plotësohet - ndryshohet pika 20 e raportit me nr. 01-572, dt. 10.10.2023 me lëndën: E drejta Biznesore (MN, 4 orë), ku angazhohet z. Albin Gallopi.

- **FAKULTETI I FILOLOGJISË**

Miratohet propozimi i Këshillit të Fakultetit të Filologjisë sipas raportit me nr. 02-506, dt. 20.10.2023 në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren për angazhimin e personelit akademik për vitin akademik 2023/2024.

Plotësohet - ndryshohet pika 3 me lëndët: Hyrje në shkencën e letërsisë; Praktikum i gjuhës shqipe; Romani shqiptar; Eseistikë; Kulturë dhe qytetërim shqiptar, të raportit (i plotësuar sipas raportit të komisionit për shqyrtimin e ankesave me nr. 02-505), ku angazhohet znj. **Elita Omaj**.

- **FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT**

Miratohet propozimi i Këshillit të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit sipas raportit me nr. 01-278, i datës 09.10.2023.

- **FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE**

Miratohet propozimi i Këshillit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike sipas raportit me nr. 333-23, dt. 10.10.2023, i plotësuar me raportin e komisionit të ankesave me nr. 333-23, i datës 19.10.2023.

Udhëzim Juridik: Kundër vendimit të Senatit (njoftimit zyrtar të publikuar në uebfaqen e UUHP-së) lejohet ankesa sipas Rregullores për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren me nr. ref. 01-05/A, neni 8, parag.11, në afat prej 7 ditësh, në Komisionin e Ankesave në nivel të Senatit.

Kryesuesi i Senatit
Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani